



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 09
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302
Prishtinë, më 24 janar 2018, në orën 10:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Besa Baftiu, Enver Hoti, Miljana Nikoliq, Flora Brovina, Bekim Haxhiu, Fikrim Damka, Fatmire Kollçaku-Mulhaxha, dhe Time Kadrijaj.

Munguan: Faton Topalli, Haxhi Avdyli dhe Naser Rugova.

Pjesëmarrës të tjerë: Ervin Ibrahimimi – UNDP, Ardian Halimi UKZ, Artan Murati- KDI, Shefki Kastrati -NDI dhe mediat.

Stafi mbështetës i Komisionit: Shpresë Haxhijaj- koordinatore e komisionit, Muhamet Bytyçi-zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi Besa Baftiu, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

REND I DITËS:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i draft planit të punës së Komisionit për vitin 2018;**
- 3. Të ndryshme.**

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Shqyrtimi i draft- planit të punës së Komisionit për vitin 2018;

Besa Baftiu: Sipas rendit të ditës sot do të diskutojmë për draft planin e punës, që e patëm edhe në mbledhjen e kaluar. Nga mbledhja e kaluar pati edhe propozime të reja dhe tani në këtë mbledhje do ta plotësojmë me të gjitha propozimet. Një dakordim nuk e patëm rreth Ligjit që do ta monitorojmë, ju ftoj që t'i bëni propozimet konkrete se cilin ligj do ta monitorojmë.

Besoj se kësaj here është radha që të monitorojmë ndonjë ligj nga fusha e punës dhe mirëqenies sociale. Në mbledhjen e kaluar pata propozuar monitorimin e zbatimit të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare si një ligj i cili është miratuar tash sa kohë dhe i cili po has në vështirësi të shumta gjatë zbatimit. Pres edhe propozimet tuaja se cilin ligj do të fillojmë ta monitorojmë.

Flora Brovina: Monitorimi i Ligjit për Shërbime Sociale dhe familjare lidhet edhe me ligjin që e kemi në procedurë të amendamentimit, Projektligjin për Ndërmarrjet Sociale. Ka shumë organizata që janë të gatshme të ofrojnë shërbime sociale dhe familjare, por ligji nuk ua ka ofruar këtë mundësi. Pajtohem që të monitorohet ky Ligj, ndërsa Ligji për produkte dhe pajisje mjekësore është një ligj që ka nevojë të monitorohet çdo mandat sepse ka probleme të shumta. Te ligji i duhanit, ligji nuk është i keq por kërkon monitorim më të madh nga inspektorati.

Time Kadrijaj: Secili ligj e ka rëndësinë e vet dhe është mirë të monitorohet, por pasi nuk kemi mundësi të gjitha ligjet t'i monitorojmë, të fillojmë me një ligj dhe nëse e përfundojmë shpejt të monitorojmë edhe një ligj tjetër. Nëse monitorimi do të jetë më dinamik, atëherë edhe do të kemi rezultate.

Fatmire Mulhaxha-Kollçaku: Nga përvoja e di që monitorimi është punë dinamike, dhe nuk mund ti monitorojmë dy ligje njëherësh. Sa i përket Ligjit për Produkte dhe Pajisje medicinale ndoshta do të jetë mirë ta bëjmë një mbledhje të Komisionit dhe ti ftojme përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe AKPPM-së, dhe ta diskutojmë zbatueshmërinë e atij ligji.

Enver Hoti: Plani i punës ka një agjendë të ngjeshur, por propozoj që një Ligj ta monitorojmë nga fusha e punës dhe një nga fusha e shëndetësisë. Nga fusha e punës propozoj të monitorohet Ligji i Punës apo Ligji për Inspektoratin e Punës, pasi po kemi probleme në zbatim të Ligjit të Punës. Në muajin maj, propozoj të fillojmë me monitorimin e Ligjit të punës sepse atëherë edhe fillon sezoni i punës në ndërtimtari, ku ka probleme, qoftë për kushtet e punës, qoftë për kontrata etj.

Besa Baftiu : Ligji i Punës është monitoruar dhe tani është edhe në agjendë për plotësim dhe ndryshim dhe do të përfshijmë edhe rekomandimet nga raporti i monitorimit.

Flora Brovina: Ligji i Punës është monitoruar dhe i ka rekomandimet që janë miratuar edhe në Kuvend. Kur ta amendantojmë, do ta mbajmë edhe një tryezë pune për këtë Ligj.

Bekim Haxhiu: Plani i Punës është dinamik sepse edhe fushëveprimi i Komisionit është i gjerë. Do ishte mirë që Ligji për Shëndetësi dhe Ligji për Sigurime Shëndetësore të vinë më herët, por ajo të mbetet në përgjegjësi të Ministrisë së Shëndetësisë. Mendoj se sa i përket monitorimit do të mund të fillojmë monitorimin e dy ligjeve përnjëherë. Propozoj që pasi është monitoruar Ligji i Punës tani ta monitorojmë Ligjin për Sigurinë në Punë, sepse numri i punëtorëve që po humbin

jetën në vendin e punës është i madh. Po ka edhe lëndime në punë sidomos në Ndërmarrjen Trepça, të cilat edhe po fshehën e nuk po raportohen.

Kryetarja: Pajtohem me propozimin që të fillojmë me monitorimin e një ligji, e nëse e përfundojmë shpejt, atëherë të fillojmë edhe me një ligj tjetër.

Enver Hoti: Pajtohem që një herë të fillojmë monitorimin e një ligji, gjithashtu, ti diskutojmë edhe rekomandimet e monitorimit të Ligjit të Punës.

Fatmire Mulhaxha – Kollçaku- Ndoshta do të jetë mirë ta angazhojmë edhe një ekspert, i cili do të na ndihmonte në monitorim.

Time Kadrijaj: Sa i përket monitorimit të Ligjit për Produkte dhe Pajisje Medicinale , mendoj se duhet ta bëjmë një takim dhe ta ftojme shefin e AKPPM-së dhe ti diskutojmë problemet e zbatimit të atij ligji. Planin e punës ta miratojmë si është, e pastaj mund ta plotësojmë sipas nevojës.

Flora Brovina: Ne kemi edhe drejtorin për hulumtime brenda Kuvendit , i cili mund t'na ndihmojë me hulumtime të fushave të ndryshme.

Kryetarja: Gjatë monitorimit të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare, duhet të bashkëpunojmë edhe me shoqërinë civile, të cilët janë të angazhuar shumë në këtë fushë.

Kryetarja, Pas diskutimeve konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, nxori këtë:

Përfundim:

Me shumicë votash për, Komisioni miratoi Planin e punës së Komisionit për vitin 2018.

Kryetarja: Pasi miratuam Planin e Punës, të formojmë edhe Grupin e Punës për monitorimin e Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare.

Pas diskutimeve që u zhvilluan, komisioni nxori këtë:

V E N D I M

1. Formohet Grupi i Punës për monitorimin e Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare si dhe Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare.

2. Përbërja e Grupit të Punës:

- 2.1. Time Kadrijaj , kryesuese
- 2.2. Fatmire Mulhaxha -Kollçaku, anëtare
- 2.3. Flora Brovina , anëtare
- 2.4. Naser Rugova , anëtar.

4. Të ndryshme.

Kryetarja: Për këtë pikë po ua përkujtoj, që nesër në rend të ditës të seancës e kemi Rezolutën, të cilën e ka propozuar Komisioni jonë, dhe shpresojmë se do të përkrahet nga të gjithë deputetët.

Gjithashtu një çështje tjetër është raporti i auditimit të Sistemit të Informimit Shëndetësor, të cilin e ka kërkuar Kuvendi. Pra raportin e ka sjell Auditori Kombëtar dhe besoj se do ta diskutojmë në ndonjërin nga mbledhjet e Komisionit, ku do të ftohet edhe ministri i shëndetësisë dhe Zyra e Auditorit .

Flora Brovina: Sa i përket monitorimit të Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Qeveris së Kosovës dhe “UnicreditBank Austria AG” për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të kardiologjisë invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, më duket se ministri nuk e kishte kuptuar rolin dhe rëndësinë e Komisionit tonë në monitorimin e kësaj marrëveshjeje, prandaj mendoj se duhet ta bëjmë një takim dhe ta kuptojmë gjendjen reale rreth zbatimit të marrëveshjes.

Fikrim Damka: Ta mbajmë një takim me sekretarin e Ministrisë së Shëndetësisë, dhe me drejtorin e SHSKUK-së, dhe ta përfundojmë këtë çështje e cila u zvarrit mjaftë. Ne kemi qenë të ngarkuar ta monitorojmë vetëm aneks kontratën në shumë prej 500 mijë euro, dhe me sa kemi kuptuar ajo aneks kontratë është refuzuar nga ish- ministri i shëndetësisë dhe është marr obligim të rregullohet salla nga vet ministria. Prandaj, pasi është tërheq aneks kontrata, tani edhe ne duhet ta përfundojmë këtë çështje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:20.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Besa BAFTIU